



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI**

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, neneve 6.2 dhe 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 i datës 27.12.2006 dhe nenit 18.1 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 14 nëntor 2014, miratoi,

### **VENDIM**

#### **PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE**

##### **Neni 1**

Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Podujevës, për ndërrimin e destinimit të përherëshëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar sipas ngastrës kadastrale nr. 747-0 kultura – kullosë kl. 3 vendi i quajtur Te xhamija në sipërfaqe prej 21954 m<sup>2</sup> prej të cilave 10000 m<sup>2</sup> duhet të shfrytëzohet për ndërtimin e shkollës, Zona kadastrale Batllavë, certifikata nr. 08-095-68722 të datës 15.08.2014.

##### **Neni 2**

Investitori obligohet që paluajtshmërinë përkatëse ta shfrytëzojë për ndërtimin e objektit të shkollës.

##### **Neni 3**

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

##### **Neni 4**

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

##### **Neni 5**

Vendimin e zbatojnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

##### **Neni 6**

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-320-92247**  
**Podujevë,**  
**14 nëntor 2014**



Kryesuesi i Kuvendit  
**Mehmet Gashi**